

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe nenit 8 të Ligjit për Zonat e veçanta të Mbrojtura nr.03/L-039/2008, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike si dhe zhvillimit të kontrolluar të Qendrës Historike të Prizrenit, Kuvendi i Kosovës, miraton

PROJEKTLIGJIN

PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT (Drafti i parë)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e tërësive të trashëgimisë kulturore dhe historike të Qendrës Historike të Prizrenit, duke ruajtur kontekstin historik, kulturor, arkitektural, kontrollimin e ndërtimeve dhe aktiviteteve tjera kulturore në kuadër të kësaj Zone të Veçantë, duke respektuar llojllojshmërinë e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare të komunitetit brenda kësaj zone si dhe administrimin, ruajtjen, konservimin dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të kësaj Qendre duke u bazuar në kriteret e Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit.

Neni 2 Përkufizimet

1. Plani i Konservimit- nënkupton Planin Rregullues urban.....
2. Këshilli Mbikqyrës- nënkupton organin mbikqyrës, i cili..etj
3. Organi kompetent komunal nënkupton Drejtoratin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit në Prizren etj.

Neni 3 Qendra Historike e Prizrenit

1. Zona e Veçantë e Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të themelohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM dhe do të përfshijë këto objekte : Kishën e Virgjëreshës së Shenjtë të Levishës; lagjen e vjetër “Mëhalla Marash”; Kishën e Shpëtimtarit të Shenjtë; Shkollën Ortodokse për Priftërinj e Kirilit dhe Metodit të Shenjtë; Kompleksin e Rezidencës Episkopike (që përfshin rezidencën e Peshkopit, Katedralen e Gjergjit të Shenjtë, Kishat e Gjergjit të Shenjtë (Runovic)dhe Nikollës së Shenjtë (Tutic)...etj.

2. Kjo zonë do të definohet me një hartë që do ti bashkangjitet këtij ligji, si pjesë integrale e tij.

Neni 4

1. Qendra Historike e Prizrenit , për vlerat historike, kulturore, arkitektonike dhe urbanistike, i nënshtrohet Ligjit për Trashëgimi Kulturore nr.02/L-88/2006 dhe Konventës së UNESCO-s për trashëgimi kulturore si dhe kriterëve për Konservimin dhe Zhvillimin e Prizrenit.
2. Qendra Historike e Prizrenit konsiderohet si pjesa më me vlerë e qytetit të Prizrenit dhe ajo duhet të ruhet në tërësi si kompleks monumental urbanistik, arkitektonik dhe kulturor.

Neni 5

Plani i Konservimit të Qendrës Historike të Prizrenit

Lejimi i ndërtimit në këtë zonë bëhet pa cenuar vlerat për të cilat janë vënë në mbrojtje..... (të vazhdohet me Planin e Konservimit)të diskutohet gjithashtu lidhur me kategorizimin e objekteve, punimet restauruese dhe konservuese, mjediset e gjelbruara, ndërhyrjet në infrastrukturën e qendres, vendosja e elementeve dekoruese dhe reklamave, lëvizja e automjeteve, masat e mbrojtjes së monumenteve të kulturës nga fatëkeqësitë natyrore dhe zjarri etj.

Neni 6

Aktivitetet e ndaluara

1. Aktivitetet e ndaluara brenda Zonës Historikë të Prizrenit bazuar në nenin 5 të Ligjit për Zonat e veçanta të Mbrojtura janë:
 - 1.1. ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve tranzite në zonat rurale; dhe
 - 1.2. ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Neni 7

Aktivitete e kufizuara

1. Aktivitetet e kufizuara sipas nenit 6 të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura janë:

- 1.1. ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri/kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet;
 - 1.2. ndërtimi i rrugëve;
 - 1.3.ndërtimi i magazinave,punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, super-marketeve,klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale;
 - 1.4. tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; dhe
 - 1.5. urbanizimi i tokës bujqësore.
2. Para se të fillohet me aktivitetet e përmendura, duhet të kërkohet pëlqimi i Kishës Ortodokse Serbe por edhe të komuniteteve tjera fetare poqese ndërtimi apo aktiviteti zhvillohet në afërsi të këtyre objekteve fetare
 3. Për zbatimin dhe monitorimin e këtyre zhvillimeve do të themelohet një mekanizëm mbrojtës(Këshilli mbikqyrës) i cili do të sigurojë mbrojtjen e çdo monumenti kulturor.

Neni 8

Mekanizmi mbrojtës(Këshilli mbikqyrës)

1. Mekanizmi mbrojtës (Këshilli Mbikqyrës)do të formohet në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren.(të diskutohet përbërja e tij)
2. Këshilli Mbikqyrës ka për detyrë të këshillojë dhe të kujdeset për mbrojtjen e barabartë të secilit monument historic, kulturor dhe fetar duke patur kujdes në tri llojshmërinë e feve dhe identitetin e tyre dhe duke respektuar Konventën e UNESCO-s për diversitetin kulturor.
3. Këshilli Mbikqyrës do të kujdeset që në rastin e kërkesës për ndërtim në afërsi të një objekti fetar, të kërkojë se a është ajo kërkesë në pajtim me planin hapësinor apo urban të asaj komune, a e ka marrë pëlqimin nga Instituti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, a e posedon pëlqimin e komunitetit fetar përkatës në afërsi të të cilit monument kërkohet ndërtimi si dhe të verifikojë lejen për ndërtim nga organi kompetent komunal.
3. Pas sigurimit të këtyre dokumenteve dhe verifikimit nga ana e mekanizmit mbrojtës, do të lejohet ndërtimi brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

4. Në rast të kërkesës për ndonjë aktivitet kulturor, pëlqimi duhet të sigurohet nga Drejtorati për Kulturë i komunës së Prizrenit në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren si dhe pëlqimin e komunitetit fetar përkatës në afërsi të të cilit monument kërkohet zhvillimi i aktivitetit(apo pëlqimin e të gjitha komuniteteve fetare).
5. Mekanizmi mbrojtës (Këshilli Mbikqyrës)do të verifikojë dokumentet e lartpërmendura para se të fillohet me aktivitetin kulturor.
6. Këshilli Mbikqyrës (Këshilli Mbikqyrës)gjithashtu i rekomandon dhe këshillon strukturat lokale te vetëqeverisjes, masa për përmirësimin e standardeve të vendit për administrimin e mirë, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit.
7. Këshilli Mbikqyrës bashkëpunon me organet e pushtetit qëndror në bazë të marrëveshjes në mes tyre duke respektuar Ligjin për trashëgiminë Kulturore nr.02/L-88/2006.

Neni 9

Procedura e aplikimit dhe ankesa

1. Kërkesa për ndërtim fillimisht i dërgohet organit kompetent komunal për çështje të urbanizmit, i cili e shqyrton kërkesën duke e kërkuar edhe pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren.
2. Në rast se kërkesa për ndërtim dhe zhvillim të aktiviteteve të reja në Qendrën Historike të Prizrenit, refuzohet nga organi kompetent komunal, ankesa i dërgohet brenda 15 dite pas marrjes së vendimit, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, për shqyrtim të ankesës.
3. Poqese kërkesa për ndërtim lejohet nga organi kompetent komunal, atëherë duhet të kërkohet edhe pëlqimi nga komunitetet fetare.
4. Poqese nga komuniteti fetar ipet pëlqimi, atëherë organi kompetent komunal e lëshon lejen urbanistike dhe pastaj lejen e ndërtimit për objektin në fjalë.
5. Në rast se komuniteti fetar e refuzon këtë kërkesë, çështja përcillet në Këshillin për Zbatim dhe Monitorim, i cili pas konsultimit me institucionet relevante,ndërmjetëson në zgjidhjen e çështjes.
6. Poqese çështja në instancë të fundit nuk zgjidhet nga Këshilli për Zbatim dhe Monitorim, çështja i dërgohet Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, që ta zgjidhë çështjen.

Neni 10
Dispozitat Ndëshkuese

Këto dispozita duhet të bazohen në ndëshkimet e parapara në U.A –në nr.5 mbi zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi rregullimin e mbikqyrjes, të ndëshkimeve dhe marrjen e masave, masat ndëshkimore që parashihen në Ligjin për Ndërtim dhe Ligjin për Trashëgimi Kulturore nr.02/L-88/2006....